

Taksa administrative

Në përputhje me numrin tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10 dhe 17/11), për veprimet dhe aktet që ndërmerren para Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës paguhen taksa administrative si më poshtë:

- Kërkesë për përjashtim individual dhe për vazhdimin e afatit për përjashtim individual të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikës së koordinuar – 5.000 denarë
- Aktvendim për miratimin e kërkesës për përjashtim individual dhe për vazhdimin e afatit për përjashtim individual të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikës së koordinuar – 5.000 denarë
- Kërkesë për shfuqizim, anulim dhe ndryshim të aktvendimit për përjashtim individual të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikës së koordinuar – 1.000 denarë
- Aktvendim për shfuqizim, anulim dhe ndryshim të aktvendimit për përjashtim individual të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikës së koordinuar – 1.000 denarë
- Njoftim për përqendrim – 6.000 denarë
- Aktvendim me të cilin, me kërkesë të palës, konstatohet se përqendrimi nuk bie nën dispozitat e ligjit – 5.000 denarë
- Aktvendim me të cilin konstatohet se përqendrimi është në përputhje me dispozitat e ligjit – 30.000 denarë
- Kërkesë për përjashtim nga pezullimi i përqendrimit – 5.000 denarë
- Aktvendim me të cilin miratohet kërkesa për përjashtim nga pezullimi i përqendrimit – 5.000 denarë
- Aktvendim me të cilin konstatohet se përqendrimi nuk është në përputhje me dispozitat e ligjit – 5.000 denarë
- Kërkesë për shqyrtim (inspektim) të shkresave të lëndës para Komisionit – 300 denarë
- Kërkesë për përpilim kopjeje ose fotokopjeje të shkresave të lëndës para Komisionit – 300 denarë

Pagesat për taksat administrative të sipërpërmendura kryhen në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840 xxx¹103161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300. Detyrimin për pagesën e taksave administrative e ka kërkuesi, përkatësisht paraqitësi i njoftimit.

¹ Shënohet kodi i komunës në të cilën ndodhet selia e kërkuesit, përkatësisht parashtruesit të njoftimit, ose përfaqësuesit të tij juridik që e kryen pagesën. Nëse pagesa kryhet nga një person me seli jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, shënohet kodi i komunës ku ndodhet selia e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Qendër – 182).